



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.404 /2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, për shkak të shpifjeve në tubime publike, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 31.10.2013, nga subjekti politik PDK dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se subjekti politik LDK dega në Ferizaj, gjatë fushatës zgjedhore në tubimet publike, si dhe në debatet publike në televizionet lokale dhe qendrore, kanë shpifur dhe nxitur urrejtje ndaj subjektit politik PDK dhe kandidatit për kryetar komune z. Agim Aliu, me të cilat deklarata publike kanë nxitur urrejtje. Sipas parashtruesit të ankesës, subjekti politik LDK ka keqpërdorur fushatën zgjedhore duke fyer rregullën zgjedhore nr 11/2012, Kodi i Mirësjelljes për Subjekte Politike si dhe dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Republikës të Kosovës.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë materiale linqet nga deklaratimet publike .

PZAP-i, e informoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me datë 31.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 01.11.2013.

PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) sipas afatit të caktuar, ku subjekti politik LDK mohon pretendimet e ankuesit dhe thekson se kjo ankesë është e pabazë e bërë për motive politike dhe elektorale.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Pretendimet ankimore se në tubime publike gjatë fushatës zgjedhore subjekti politik LDK me deklaratata publike kanë nxitur shpifje dhe urrejtje ndaj subjektit politik PDK, PZAP-i i konsideron se janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara, sepse nga dëshmia e ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk është dëshmi bindëse me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar dhe nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar shkeljen e supozuar. Andaj PZAP-i ,konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 404/2013 më datën 04.11.2013

Kryesuesi i Panelit

Nehat Idrizi



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*